



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 230/1 Prot

Tiranë, më 26.02.2020

V E N D I M

Nr. 27, datë 26.02.2020

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Këlcyrë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë subjekt”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Këlcyrë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65 (nr. 1453 prot), datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si edhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje

me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Këlcyre.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Këlcyre, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2019, me aktin e Kryetarit të Bashkisë, Vendim nr. 1 prot., datë 03.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Këlcyre për vitin 2019”. Kjo strukturë organizative vazhdon të jetë në fuqi edhe në momentin e verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Këlcyre ka **179** pozicione pune nga të cilat **44** prej tyre konsiderohen si pjesë e shërbimit civil. Sipas kategorive të shërbimit civil këto pozicione klasifikohen: **8** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **36** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht, gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **34** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues, ndërsa **10** pozicione të shërbimit civil rezultuan vende të lira.

Rezulton se nga mbikëqyrja e mëparshme e këtij institucioni nuk është përmbushur asnjë pikë e Vendimit paralajmërues nr. 27 datë 13.04.2018, të Komisionerit. Aktualisht në këtë institucion ende nuk ka filluar aplikimi i Ligjit për Shërbimin Civil.

Rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin të evidentuara në institucion, paraqiten si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës zyre dhe protokoll në Zyrën për të Drejtën e Informimit + BE dhe Protokoll”, emëruar me aktin nr. 01, datë 03.01.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist për Marrëdhëniet me Publikun dhe BE në Zyrën për të Drejtën e Informimit + BE dhe protokoll”, emëruar me aktin nr. 08, datë 04.02.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Zyrës dhe Nëpunës Zbatues në Zyrën Financës dhe Buxhetit”, emëruar me aktin nr. 49, datë 29.04.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialiste i Lartë/Inspektor Finance dhe Buxhetit në Zyrën e Financës dhe Buxhetit”, emëruar me aktin nr. 39/1, datë 17.05.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialiste pagash dhe Inventarësh në Zyrën e Financës dhe Buxhetit”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion sipas regjistrimit themeltar në datën 01.04.2001 (nuk gjendet akt emërimi);
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore”. emëruar me aktin nr. 27, datë 02.05.2018;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Tarifave Vendore në Zyrën e Taksave e Tarifave Vendore”, emëruar me aktin nr. 108, datë 01.10.2015;

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Tarifave Vendore në Zyrën e Taksave e Tarifave Vendore”, emëruar me aktin nr. 67, datë 01.09.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Tarifave Vendore në Zyrën e Taksave e Tarifave Vendore”, emëruar me aktin nr. 103, datë 22.12.2017;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë, Inspektor Ndihmës Ekonomike dhe PAK, në NJA-Dishnicë”, emëruar me aktin nr. 01, datë 03.01.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialiste e Shërbimit Social, në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion sipas regjistrimit themeltar në datën 16.07.2016 (nuk gjendet akt emërimi);
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Ndërtimi në Zyrën e Urbanistikës, Planifikim Territori”, emëruar me aktin nr. 33, datë 13.05.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë i Emergjencave Civile, Kadastër, Magazinier në Zyrën e Urbanistikës, Planifikim Territori”, emëruar me aktin nr. 16, datë 13.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë (Miratimi i Strukturës nga Kryetari datë 01.02.2018);
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve Publike”, emëruar me aktin nr. 06, datë 14.01.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Shërbimesh në Zyrën e Shërbimeve Publike”, emëruar me aktin nr. 86, datë 01.09.2015;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë Mjedisi dhe Higjene në Zyrën e Shërbimeve Publike”, emëruar me aktin nr. 40, datë 08.05.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë Veteriner në Zyrën e Shërbimeve Publike”, emëruar me aktin nr. 18, datë 16.03.2018;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist Shërbimesh dhe Strehimit në Zyrën e Shërbimeve Publike”, emëruar me aktin nr. 68, datë 01.09.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë për Arsimin dhe Kulturën në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 01, datë 03.01.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë për Kulturën dhe Muzikën në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 72, datë 05.10.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist për Kulturën dhe Trashëgiminë në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 71, datë 05.10.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Inspektor për sportet, (Trainer sportesh) në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 47, datë 20.06.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist Biblioteke pranë Qendrës Kulturore në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 16, datë 12.03.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë për Aktivitete Kulturore në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 04, datë 04.01.2018;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Punonjëse Biblioteke pranë Qendrës Kulturore në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 26, datë 23.04.2018;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Punonjëse Biblioteke pranë Qendrës Kulturore në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 40, datë 08.05.2018;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist për Turizmin dhe Statistikat në Zyrën e Arsim, Kulturë-Sport”, emëruar me aktin nr. 09, datë 04.02.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist i Lartë, Inspektor Ndihmës Ekonomike dhe PAK, në NJA-Sukë”, emëruar me aktin nr. 01, datë 03.01.2019;

- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Lartë Pyjesh e Kullotash*”, emëruar me aktin nr. 61, datë 31.07.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Teknik i Mesëm Pyjesh (Specialis)*”, emëruar me aktin nr. 5, datë 14.01.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Lartë Pyjesh e Kullotash*”, emëruar me aktin nr. 55, datë 01.07.2019;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Lartë Inspektor për Ujitje dhe Kullim*”, emëruar me aktin nr. 16, datë 13.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë (Miratimi i Strukturës nga Kryetari datë. 01.02.2018);
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Mirëmbajtjeve të Rrugëve*”, emëruar me aktin nr. 35, datë 13.05.2016;
- ✓ *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Lartë, Inspektor Ndhmës Ekonomike dhe PAK, në NJA-Ballaban*”, emëruar me aktin nr. 16, datë 13.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë (Miratimi i Strukturës nga Kryetari datë. 01.02.2018);

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit, të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të neneve 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështirësi të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhëniet e punës të lidhura në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, për rastet e pozicioneve të lira në institucion, në përputhje me nevojat e strukturës që është në fuqi në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

Nga ana tjetër, evidentohet nevoja për të rishikuar përshkrimet e punës për pozicionet që përfshihen në shërbimin civil, me qëllim që të përditësohen me ndryshimet e strukturës dhe kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Këlcyre, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **34** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara nominalisht në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të rishikohen përshkrimet e punës sipas nevojave të institucionit dhe rregullave e procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.
3. Njësia përgjegjëse të shpallë për t’u plotësuar pozicionet e lira në shërbimin civil, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi, e më tej të vijnë procedurat e konkurrimit, duke realizuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*.
5. Të përmbyllet procesi i mbikëqyrjes i cili është materializuar me vendimin nr. 108, datë 27.04.2017, të Komisionerit dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas urdhërimeve të dispozitivit të këtij vendimi paralajmërues të Komisionerit.

6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Këlcyre, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Këlcyre, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë dhe Ministria e Brendshme. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Këlcyre të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha